

**VENDIM**  
**Nr.259 date 7.6.1993**  
**(I shfuqizuar)**

**PER**  
**KRIJIMIN E KESHILLIT TE RREGULLIMIT TE TERRITORIT TE SHQIPERISE**

Ne mbeshtetje te ligjit te urbanistikes nr.7693, date 6.4.1993, kreu II, neni 7, me propozimin e Ministrise se Ndertimit, te Strehimit dhe Rregullimit te Territorit, Keshilli i Ministrave

**V E N D O S I :**

1. Krijimin e Keshillit te Territorit te Shqiperise (KRRTSH) prane Keshillit te Ministrave.
2. Keshilli i Rregullimit te Territorit te Shqiperise eshte organ vendimor dhe miraton studime te percaktuara ne nenin 7 te ligjit te uirbanistikes.
3. Keshilli i Rregullimit te Territorit te Shqiperisenperbehet nga 17 anetare.
4. Keshilli i Rregullimit te Territorit te Shqiperise ka kete perberje:
  - a) Kryetari i Keshillit te Ministrave - kryetar i KRRTSH
  - b) Ministri i Ndertimit, Strehimit dhe Rregullimit te Territorit - zevendes kryetar i KRRTSH.
  - c) Drejtori i Drejtorise se Rregullimit te Territorit - sekretar i KRRTSH.
  - ç) Anetare te KRRTSH nga Ministria e Ndertimit, Strehimit dhe Rregullimit te Territorit, Ministria e Transporteve dhe e Komunikacioneve, Ministria e Bujqesise dhje e Ushqimit, Ministria e Turizmit, Ministria e Industrise, Burimeve Minerare dhe Energjertike, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Financave dhe e Ekonomise dhe Komiteti i Mbrojtjes se Mjedisit, lista emerore e te cileve miratohet nga kryetari i Keshillit te Rregullimit te Territorit te Shqiperise.
5. Drejtoria e rregullimit te territorit ne Ministrine e Ndertimit, te Strehimit dhe Rregullimit te Territorit kryen funksionin e sekretarise teknike te Keshillit te Rregullimit te Territorit te Shqiperise.
6. Mbledhja e KRRTSH drejtohet nga kryetari dhe ne mungese tetij nga zevendes kryetari.
7. Keshilli i Rregullimit te territorit te Shqiperise funksionon sipas rregullores perkatese te tij, mirtuar nga kryetari i KRRTSH.

Ky vendim hyn ne fuqi menjehere

**KRYETARI I KESHILLIT TE MINISTRAVE**  
**ALEKSANDER MEKSI**

**R R E G U L L O R E**  
**PER FUNKSIONIMIN E KESHILLIT TE TERRITORIT TE SHQIPERISE**

Rregullorja e Leshillit te Rregullimit te Territorit te Shqiperise eshte mbeshtetur ne vendimin e Keshillit te Ministrave nr. , date , ku percaktohet ngritja dhe funksionimi i KRRTSH.

Keshilli i Rregullimit te Territorit te Shqiperise mblidhet nje here ne muaj, si rregull, javen e pare te çdo muaji. Ne rrsdte te vecante, kur e gjykon te arsyeshme kryetari i KRRTSH, Keshilli I Rregullimit te Territorit te Shqiperise mblidhet edhe jashte radhe.

Per cdo material qe shqyrton KRRTSH, dokumentacioni plote dorezohet ne sekretarine teknike te KRRTSH, qe eshte drejtoria e RRegullimit te Territorit ne Ministrine e Ndertimit, Strehimit dhe Rregullimit te Territorit.

Materialet qe shqyrtohen ne KRRTSH, dorezohen ne sekretarine teknike 21 dite para mbledhjes. Sekretarja teknike i shqyrton ato, ben oponencen dhe jep mendimin e saj per materialin e paraqitur.

Kur materialet e paraqitura per shqyrtim nuk i plotesojne kushtet teknike dhe nuk kane nivelin e duhur te opoaraqitjes, sekretaria I kthen per plotesim.

Sekretarja e KRRTSH regjistron ne nje regjister te vecante materialet qe dorezohen per shqyrtim ne mbledhje.

Sekretaria pergatit materialin permbledhes, i cili do te hsqyrtohet ne KRRTSH dhe, bashke me njoftimin e dates se mbledhjes, ia shperndan anetarve te KRRTSH 5 dite para mbledhjes.

Mbledhja e KRRTSH zhvillohet me pjesemarrjes e dy te tretave te anetareve dhe vendimi merret me shumice votash.

Pas shqyrtimit te materialeve te KRRTSH, nje kopje e dokumentacionit arkivohet ne arkivin e Keshillit te Ministrave, nje kopje ne arkivin e Ministrise se Ndertimit, te Strehimit dhe Rregullimit te Territorit bashke me procesverbalin e mbledhjes, si dhe kopjen e vendimit te firmosur nga kryetari ose zv.kryetari I KRRTSH.

**KRYETARI I KESHILLIT TE RREGULLIMIT TE**  
**TERRITORIT TE SHQIPERISE**  
**ALEKSANDER MEKSI**